

**Z. Juljan Hysomema** është diplomuar si Jurist në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, në vitin 2009.

Ka marrë titullin Avokat, pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë në vitin 2011.

Në vitet 2010-2021 z. Hysomema ka punuar në sektorin privat, si administrator dhe përfaqësues ligjor i disa shoqërive tregtare.

Në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka filluar punë në mars të vitit 2022, në pozicionin e Audituesit/Jurist pranë Drejtorisë Juridike duke u angazhuar në Sektorin e Përfaqësimit në Gjykatë.

Prej muajit shtator 2024 ushtron detyrën e “Kryeaudituesit” në Drejtorinë Juridike në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Në zhvillim të karrierës së tij, ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme, konferenca, seminare dhe workshope, për rritjen e kapacitetit profesional, lidhur me prokurimet publike, luftën kundër korrupsionit, etj.

Z. Hysomema është njohës i gjuhës angleze dhe italiane.